




Flash

Aksident në aksin rrugor Fushë Krujë-Milot, përplasen disa mjete, dyshohet për viktima

POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Aksident i rëndë në Fushë Krujë, përplasen disa makina, dyshohet për viktima



Tensione me tone të larta në mbledhjen e kryesisë së PD-së. Gjyha përplasat me Bashkinë për dyet e blinda: S'është shkollë ky propozim! Deputet: Mos më përmend familjen



Një përplasje vdekësore në mes të Evropës? Qfarë janë armët bërthamore nukit dhe joje e Putinit me kërcënime (Skeda, 6 pyetje dhe përgjigje)



Qeveria i dërgohet tregëve të lunda për furnizimin me naftë: Do krijojmë rezervë hidrokarburesh



Putin: Nuk do të pranojmë pagesa në dollarë dhe euro për gaz

Kronikë

Sherri për kalin la pas një viktimë në 2019, iu vihen prangat pas 3 vitesh kunatit dhe 2 shokëve të autorit! VIDEO nga momenti kur gjatë arrestimit, hedh pistoletën në tokë

Ariel Kingji dhe Shpati Lena prej 3 vitesh ishin në kërkim si bashkëpunëtor në krim të vrasjes së Arben Beqirajt në nëntor të 2019, por pavarësisht kësaj ata lëviznin të lirë në qytet.



[Sh] Redaksia

23 Mars, 09:06 | Përditësimi i fundit: 23 Mars, 10:02



VLORË- Ariel Kingji dhe Shpati Lena prej 3 vitesh ishin në kërkim si bashkëpunëtor në krim të vrasjes së Arben Beqirajt në nëntor të 2019, por pavarësisht kësaj ata lëviznin të lirë në qytet.

Dyshja së bashku me Kristo Drolli u arrestuan teksa lëviznin të lirë me makinë, deri në momentin kur forcat 'Shqiponja', iu vunë prangat. Në kuadër të operacionit "Paves" (dallgët), u bë arrestimi i Ariel Kingjit, 21 vjeç, Shpati Lena 37 vjeç dhe Gazmend Alushi 50 vjeç, të cilët të tre kishin armë me vete. Madje në pamje shikohet edhe momenti kur gjatë arrestimit, një prej të rinjve i bie arma në tokë. Arrestimi i tyre u në lagjen "Ujë i Ftohtë".




LEXO EDHE:
Vlorë, 30 vatra zjarri për 5 ditë, drejtori i zjarrfikësës: I vendosin blegtorët për të pastruar kullotat, policia nuk i arreston

Si ndodhi ngjarja ku u përfshinë të arrestuarit?

Fakti që një kalë i ka prishur qetësinë disa pushuesve që po bënin plazh në muajin gusht në Vlorë, ka shërbyer për keqtrajtimin në grup të rojës së kalit. Gazmend Alushi, i cili paguhej 100 mijë lek të vjetra në muaj nga Ermal allias Eduart Xhezo për kujdesin ndaj kalit, është dhunuar me grushte e shkelma në 4 gusht 2019 nga Arben Beqiraj, djali i tij dhe persona të tjerë familjarë që ndodheshin në lokal. Fill pasi ka shpëtuar nga rrahja e mirë, Gazmendi ka shkuar në banesën e tij, ku aty i kishte shkuar Ermali duke i thënë se kush e kishte rrahur, dhe Alushi i ka pohuar se ishte dhunuar nga "Arbeni i Çeçesë". Fill pas kësaj, Ermal Xhezo, ka mobilizuar shokët e tij si Shpati Lena dhe kunatin e tij Ariel Kingji, (sot të arrestuar) ku të gjithë janë armatosur me automatikë dhe pistoleta, duke shkuar në ambientet e lokalit të Arben Beqiraj, për t'u sqaruar lidhur me rrahjen që ata i kishin bërë kujdestarit të kalit të Ermal Xhezot. Teksa kanë shkuar për t'u sqaruar, janë ulur 3 minuta në një tavolinë dhe më pas kanë nisur përplasjet fizike deri në përdorimin e armëve, duke sjellë vrasjen e Arben Beqirajt dhe plagosjen e djalit të tij dhe Nesim Hodaj. Kjo ngjarje tronditi qytetin e Vlorës në pikun e sezonit turistik. Autor i vrasjes ka qenë Eduart Xhezo, i arrestuar, teksa shoku dhe kunati i tij kanë bashkëpunuar në krim.

Kush janë të arrestuarit?

-Kristo Drolli 50 vjeç, banues në lagjen "24 Maji", për veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit", pasi gjatë kontrollit iu gjet një armë zjarri pistoletë;
-Ariel Kingji 21 vjeç, banues në lagjen "24 Maji", Vlorë, pasi gjatë kontrollit fizik, iu gjet në brez, një armë zjarri pistoletë. Nga veprimet hetimore rezultoi se ky shtetas ishte shpallur në kërkim për veprat penale "Vrasja në rrethana cilësuese" kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit" në lidhje me ngjarjen e ndodhur në datën 04.08.2019, në lagjen "1 Maji", Vlorë.
-Shpati Lena 37 vjeç, banues në lagjen "24 Maji", i cili dyshohet si përkrahës i personit në kërkim.



Viktima Arben Beqiraj

B.K./Shqiptarja.com

TAG: Arben Beqiraj Vlore gazmend alushi shpati lena ariel kingji policia e vlorës

Komento

Komente

Durrsi: 23/03/2022 15:48
Epo te frikshem keta porshicie e vlores sipdmos keta shqiponjt do i ket trajnuar navy seals se ska munci te te kapin keta langaraqet dhe femer njer me 2 hekra ne makin cudi me duket vallahi te te kalin keta

Përgjigju

Ndalohet repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Kriza në PD, pas dorëheqjes së Bashës a duhet të tërhiqet edhe Berisha?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

Sociale



Fenomeni i zbaticës, deti në Vlorë tërhiqet 50 metra
23 Mars, 10:52

Kronikë



Aksion në Vlorë, arrestohen 3 persona, njëri i shpallur në kërkim e dy të tjerë për armëmbajtje pa leje
22 Mars, 23:24

Sociale



Gripi i shpendëve/ Vëzhgim i Report Tv, asnjë kontroll në tregun e Vlorës
22 Mars, 20:21

Kronikë



Makina merr flakë në autostradën Fier-Vlorë, shkak një shkëndijë elektrike (VIDEO)
22 Mars, 15:35

Kronikë



Vlorë, përfshihet nga flakët një sipërfaqe me ullinj në Radhimë
22 Mars, 09:40

Politikë



Ambasadori i BE-së Luigi Soreca vlerësohet me titullin 'Qytetar Nderi' në Vlorë: Këtu ndihem vërtetë si në shtëpinë time
21 Mars, 12:59

Ekonomi



Dyfishohen çmimet e apartamenteve në Vlorë, deri 1500€/m2! Breshani: Kërkesa nga shqiptarët e Kosovës, emigrantët dhe italianët

Kronikë



Vidhet gjatë natës transformatori, fshati Oshtime në Vlorë pa ujë (FOTO)
20 Mars, 21:27

Drejt Punës



Brandon, amerikanë që la Kaliforninë për tokat e Vlorës! Nga inxhinier IT në fermer, 30-vjeçari: Do mbjell fillimisht produkte organike, por do investoj dhe në blegtori



Armand Xhelili

21 Mars, 11:20

Kronikë



Arrestohet nënkomisari në Vlorë, në gjendje të dehur përplasi një makinë dhe kundërshtoi kolegët gjatë shoqërimit
19 Mars, 14:04

Kronikë



Riaktivizohet zjarri në Panaja në Vlorë, digjen dhjetëra rrënjë ullinj shekullorë! Zjarrfikësit në vendngjarje! Nuk lejohet kalimi i mjeteve në aksin Vlorë-Fier
19 Mars, 12:02

Kronikë



Kishin vjedhur disa viça në Greqi dhe po i sillnin në Shqipëri, arrestohen në kufi 4 shqiptarët
19 Mars, 10:10